




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
MASHT-MONT-MEST

Skemat mbështetëse në fushën e hulumtimit dhe shkencës-granti për projekte të vogla shkencore

Ardiana Shabaj Hyseni

Udhëheqëse në Div. e Shkencës dhe
Teknologjisë
Pikë kontakti e projektit HERAS


Datë: 14.11. 2019
Prishtinë



Veprimtaria kërkimore-shkencore rregullohet me ligjin për veprimtari kërkimore shkencore të aprovuar nga Qeveria e Kosovës në vitin 2014

- ▶ Sipas këtij ligji Qeveria e Kosovës duhet të ndajë 0.7% të buxhetit total të Kosovës, mirëpo nga ky total për shkencën dhe veprimtarinë kërkimore shkencore janë ndarë vetëm 0.1% e buxhetit të Kosovës.
- ▶ Nga viti 2019 bugjeti për shkencë rritet në 1.2 milion euro për subvencione


Duke u bazuar në këtë ligj është hartuar edhe programi kombëtar i shkencës sipas të cilit bazohen të gjitha aktivitetet dhe objektivat për ngritjen e kapaciteteve shkencore në Kosovë.




Sipas këtij programi janë paraparë 5 objektiva për të mbështetur synimet specifike të shkencës si dhe zhvillimin socio ekonomik të Kosovës drejt një shoqërie të dijes

Objektivat sipas planit të PKSH janë:

- Objektiv 1: Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore për veprimtari kërkimore- shkencore
- Objektiv 2: Zhvillimi i infrastrukturës kërkimore shkencore
- Objektiv 3: Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore
- Objektiv 4: Forcimi i lidhjeve midis shkencës, shoqërisë dhe ekonomisë për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.
- Objektiv 5: Përsosmëri në veprimtarinë kërkimore-shkencore

- 
- **Objektiva 1** Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore për veprimtari kërkimore shkencore
 - MASHT çdo vit ndan një fond për të përkrahur studentët e studimeve të doktoratës nga Kosova që ndjekin studimet e doktoratës në ndonjë nga 500 universitetet më të mira të botës (Lista Songhai).
 - Grandi për mobilitete afat-shkurtra për hulumtuesit nga Kosova
 - Për çdo vit ndahet fond për përkrahjen e hulumtuesve nga Kosova për prezantimin e punës së tyre shkencore në konferenca ndërkombëtare.



Objektiva II, Zhvillimi i Infrastrukturës kërkimore shkencore

- MASHT ka një fond prej 50000 eurove për paisje laboratorike

Planet afatshkurtra

- Hartëzimi i infrastruktures kërkimore shkencore në nivel vendi



Objektiva e 3, Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore

Skemat nacionale

- Granti për botime dhe kërkime shkencore
- Granti për publikime në revista ndërkombëtare me impakt factor
- Granti për zhvillimin e projekteve kërkimore shkencore, deri në 10000 euro
- Granti për projekte të përbashkëta me vendet e rajonit
- Grante të ndara nga donatorët (HERAS-MASHT) 10 projekte deri në 15000 euro.



Objektiva e 5 Përsosmëri në veprimtarinë kërkimore-shkencore

- MASHT çdo vit ndanë një fond për çmime vjetore për arritje të jashtëzakonshme në promovimin e përsosmërisë shkencore për "shkencëtarin e vitit" dhe "shkencëtarin e ri të vitit në Kosovë".
- Skemat "Mësimdhënia e bazuar në kërkim".....

Fushat prioritare sipas PKSH

Të gjitha keto aktivitete që MASHT realizon për shpërndarjen e fondeve të ndara për shkencë dhe Inovacion në Kosovë, janë të ndara sipas prioriteteve të përcaktuara sipas programit Kombëtare të shkencës ku sipas këtij programi janë parapare 5+1 fusha prioritare:

- Burimet natyrore, energjia dhe mjedisi;
- Prodhimi bujqësor dhe siguria e ushqimit;
- Kërkimet shkencore në mjekësi;
- Studimet shoqërore dhe ekonomike;
- Studimet gjuhësore, kulturore dhe historike;
- Teknologjia informative dhe komunikuese.

Granti për zhvillimin e projekteve kërkimore-shkencore

- ▶ UA për aplikim në projekte të vogla shkencore (UA nr. 12/2016) <https://masht.rks.gov.net/uploads/2016/12/rotatedpdf270.pdf>
- ▶ Thirrja publike-tri faza;
- ▶ Afati 30 ditë;
- ▶ Kriteret e definuara në UA;
- ▶ Fondi (5.000-10.000 euro) për grant;
- ▶ Kohëzgjatja e projektit prej 6 muaj deri ne 1 vit
- ▶ Vlerësimi administrativ (MASHT-DVSHT);
- ▶ Vlerësimi profesional –nënkshilli shkencor sipas fushave;
- ▶ Vendimi përfundimtar – Këshilli i shkencës;
- ▶ Njoftimi i aplikantëve –përfitues të granteve (MASHT-DVSHT);
- ▶ Marëdhëniet kontraktuale –MASHT-vartësi i institucionit psh dekani;
- ▶ Egzekutimi financiar i grantit
 - ▶ Granti egzekutohet në dy këste, 1-80 %, 2-20% (pas pranimit të raportit të performancës)
 - ▶ Bartësi i projektit i obliguar të raportoj çdo tre muaj për ecurinë e projektit (në dispozicion formatet e raportimit)
 - ▶ Bartësi i projektit i obliguar të publikoj një punim me impakt faktor.

UA per projekte te vogla

Në udhëzim janë të përcaktuara, kategoritë që financohen, kriteret e aplikimit, fushat shkencore që mbështeten, kërkesat dhe procedurat e aplikimit etj

- **Kategoritë e shpenzimeve që mund të financohen**

- Granti mbulonë shpenzimet e mëposhtme që lidhen me projektin:

- **pajisje të posaçme:**

- pajisje laboratorike

- mjete shpenzuese

- Softwerë

- libra etj

- vizita afatshkurtra

- Konferenca ku prezentohen rezultatet e projektit përfitues

shpenzime udhëtimi dhe akomodimi

- **Shpenzime të punës në teren.**

Shpenzime për këshilltarët e Jashtëm

Pagesa për studentë të angazhuar në projekt

Kriteret per aplikim

- ▶ I gjithë aplikimi duhet të bazohet në një projektpropozim shkencor që ka mundësi të kontribuojë në mënyrë domethënëse për progresin shkencor në Kosovë.
- ▶ Aplikanti në cilësinë e Udhëheqësit të projektit duhet të ketë titullin e doktoraturës.
- ▶ Ti ketë të botuara në revista të njohura shkencore ndërkombëtare të paktën një punimë shkencore në tri vitet e fundit apo brenda kësaj periudhe të ketë të botuar në vend së paku një monografi shkencore.
- ▶ Aplikimi për grant bëhet në bazë të dispozitave të Ligjit për Veprimtari Kërkimore-shkencore Nr. 04/L-135 dhe kushteve të veçanta të vëna në këtë udhëzim.
- ▶ Përfituesit e grantit, duhet ta përmbushin grantin duke punuar në mënyrë të rregullt në një institucion kërkimoro-shkencor të jenë të përfshirë në mënyrë aktive në hulumtim, mësimdhënie dhe këshillim.
- ▶ Projektet te propozuara nuk mund te zgjasin me pak se 6 muaj dhe jo me tepër se 12 muaj.
- ▶ Çdo projekt duhet të përfshijë të paktën 3 hulumtues nga një institucion i vetëm në të cilin janë të punësuar si dhe në rastin e Universiteteve të jenë nga e njëjta njësi akademike dhe se paku 2 studente te masterit ose doktoratës.
- ▶ Çdo projekt duhet te përfshijë si këshilltarë të jashtëm një ekspert të huaj të fushës së veçantë të hulumtimit.
- ▶ Udhëheqësi i projektit nuk mund të jetë një anëtarë i ndonjë projekti tjetër të papërfunduar.
- ▶ Udhëheqësi i projektit nuk mund te konkuroje me projekt te ri dhe nuk mund te jete anëtar i ndonjë projekti tjetër përderisa nuk e ka përmbyllur projektin paraprak.
- ▶ Projekti permbyllet me dorezimin e raportit përfundimtar te udhëheqësit te institucionit mbështetës, me publikimin e rezultateve ne ndonje reviste nderkombetare me impakt faktor ose konference nderkombetare si dhe përmbushjen e te gjithave obligimeve financiare sipas kontrates.
- ▶ Një aplikues mund të jetë bartës i vetëm një projekti, dhe njëkohësisht nuk mund te jete anëtar i ndonjë projekti tjetër.
- ▶ Anëtari i nje projekti mund të jetë njëkohësisht edhe anëtarë i nje (1) projekti tjeter



Fushat shkencore që mbështeten

- ▶ **Mbeshteten projektet qe u përkasin fushave shkencore te meposhtme(në përputhje me Programin Kombëtar të Shkencës) :**
 - ▶ Burimet natyrore, energjia dhe mjedisi
 - ▶ Prodhimi bujqësor dhe siguria e ushqimit
 - ▶ Kërkimi mjekësor
 - ▶ Studime ekonomike dhe sociale
 - ▶ Studime gjuhësore, kulturore dhe historike
 - ▶ Hulumtime ndërdisiplinare në fushën e teknologjisë, komunikimit dhe informacionit në funksion të zhvillimit të pesë prioriteteve të mësipërme.



Ju faleminderit!

Ardiana Shabaj Hyseni

Udhëheqëse ne Div. e Shkencës dhe Teknologjisë

Email: ardiana.shabaj@rks-gov.net

Tel: 00383 38 211 868